



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

Nr prot. 2564

UDHËZIM

Nr. 03, datë 12.04.2022

MBI
PROCESIN E ADMINISTRIMIT TË MOSTRAVE TË PARAQITURA NGA
OPERATORËT EKONOMIKË

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP"), në mbështetje të nenit 23 të Ligjit Nr. 162, datë 23.11.2020 "Për Prokurimin Publik", neneve 2, 40 dhe 115 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", (në vijim "VKM") të ndryshuar,

Udhëzon:

1. Autoriteti/Enti kontraktor, mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë mostra të mallit, objekt prokurimi, kur gjykon se është e rëndësishme për vlerësimin e aspektit teknik të ofertës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë teknikisht vendosjen e kriterit për kualifikim për paraqitjen e mostrave, dhe ky argumentim duhet të pasqyrohet në procesverbalin e argumentimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit, i cili publikohet së bashku me dokumentet e tenderit në Sistemin e Prokurimit Publik (në vijim "SPE").
2. Paraqitja e mostrave i shërben autoritetit/entit kontraktor për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve të kërkuara për objektet që prokurohet, me qëllim që, cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara prej tij.
3. Për të dokumentuar procesin e administrimit të mostrave, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale, me qëllim sigurimin e transparencës dhe integritetit të këtij procesi.

Në këtë kuptim, në rastin kur autoriteti/enti kontraktor vlerëson si të nevojshëm dorëzimin e mostrave, në datën dhe orën e përcaktuar në dokumentat e tenderit për paraqitjen e tyre nga ofertuesit, duhet të mbajë një procesverbal. Procesverbali duhet të dokumentojë procesin e paraqitjes së mostrave, si dhe duhet të pasqyrojë detaje që përshkruajnë mostrën/at e administruara.

Në këtë rast, mbajtja e procesverbaleve i shërben vetëm procesit të paraqitjes së mostrave, deri në momentin e kthimit të tyre tek ofertuesit.

Procesverbali i mbajtur me ofertuesin/ofertuesit e pranishëm, i cili duhet të nënshkruhet nga të dyja palët (*përfaqësuesi/it i autoritetit/entit kontraktor dhe i ofertuesit/ve*), duhet t'i vihet në dispozicion ofertuesit/ve .

Në rast se, ndonjëra nga palët ka komente/pretendime, ato duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbajtur.

4. Mostrat e paraqitura nga ofertuesit duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor.

Mostrat e administruara do t'i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që, kontrata në fjalë, të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor.

Në rastin kur, procedura e prokurimit anulohet, mostrat do t'i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

5. Në rastin kur, në një procedurë prokurimi, në të cilën është kërkuar paraqitja e mostrave, ka ankesa nga operatorët ekonomikë mbi dokumentet e tenderit dhe në përfundim të shqyrtimit të tyre, administrativisht është vendosur që të mos ketë modifikime në dokumentet e tenderit pra, autoriteti/enti kontraktor do të vijojë me hapjen e ofertave, atëherë ky i fundit do të nxjerrë procedurën e prokurimit nga procesi i pezullimit në SPE, si dhe do të vendosë datën e hapjes së ofertave, në mënyrë të tillë që, t'i japë mundësi operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të dorëzojnë mostrat e kërkuara.

6. Në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, kur autoritetet/entet kontraktore kanë nevojë që të kërkojnë mostra për objektin që do të prokurojnë, duhet të kenë kujdes që mostra t'i kërkohe vetëm operatorit ekonomik të renditur në vend të parë, përpara se ai të shpallet fitues dhe kështu me rradhë ofertuesve të tjerë, duke patur në vëmendje parashikimet e pikës 17 të Udhëzimit të APP Nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël nuk duhet të kërkohe paraqitja e mostrave apo dokumentave të tjera përpara hapjes së ofertave.

7. Udhëzimi Nr. 2, datë 02.05.2019 “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomik”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

REIDA KASITA

